



EKZEMPLAR PËR NXËNËSIN

Republika e Serbisë  
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE E  
ZHVILLIMIT TEKNOLOGJIK  
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË  
ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT FILLOR

# TESTI NGA MATEMATIKA

## FORMULARI I IDENTIFIKIMIT

EMRI, EMRI I NJËRIT PRIND/PËRFAQËSUESIT TJETËR LIGJOR, MBIEMRI I NXËNËSIT

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË NXËNËSIT

--	--	--	--	--	--	--	--

SHKOLLA FILLORE \_\_\_\_\_  
VENDI \_\_\_\_\_  
KOMUNA \_\_\_\_\_


NËNSHKRIMI I MËSIMDHËNËSIT KUJDESTAR

Rezultatet mund të shihen në portalin **Moja srednja škola**: <http://mojasrednjaskola.gov.rs> duke vendosur numri e veçantë identifikues të nxënësit (shifra tetëshifrore e nxënësit). Për shkak të shkarkimit të testit në Pdf format, në pjesën ku mund të shihni rezultatet e provimit përfundimtar, është e domosdoshme të vendosni shifrën e veçantë të testit.

**Shifra e veçantë e testit:** 0a9fa56ac9bf

Nëse prindi/përfaqësuesi tjetër ligjor ka një llogari të hapur në portalin **Moj esDnevnik** ose ka një llogari në **Portal za elektronsku identifikaciju eID.gov.rs**, me të cilin mund të çaset në portalin **Moj esDnevnik**, atëherë përveç që mund të ketë çasje në rezultatet e testit përfundimtar, në portalin **Moja srednja škola**, mund të shfrytëzojë edhe shërbimet tjera elektronike si: paraqitja e ankesës ndaj rezultateve të testit përfundimtar, të dërgojë listën elektronike të dëshirave për regjistrim dhe paraqitjen apo aplikacionin elektronik për regjistrim në shkollë të mesme.

## UDHËZIME PËR PUNË

- Testi të cilin duhet ta zgjidhësh ka **20 detyra**. Për plotësimin e testit në dispozicion ke **120 minuta**.
- Detyrat nuk është e thënë t'i zgjidhësh sipas radhitjes së paraqitur.
- Gjatë punës mund të përdorësh laps grafik, gomë, vizore, trekëndësh dhe kompas, por jo kalkulatorin.
- Përgjigjet përfundimtare dhe ecurinë shkruaji me **laps kimik ngjyrë të kaltër**.
- Përgjigja e cila është e shkruar vetëm me laps grafik, laps kimik me ngjyrë të zezë ose laps “shkruaj – fshij” nuk do të pranohet.
- Tek detyrat me opsione, nuk do të pranohen përgjigjet e përmirësuara.
- Në detyrat me opsione do të marrësh 0 pikë nëse përveç përgjigjes së saktë rrethon apo nënvizon edhe ndonjë përgjigje të pasaktë.
- Ke kujdes, ngase detyrat dallojnë nga mënyra sipas të cilës duhet të përgjigjesh.
- Mos shkruaj asgjë mbi QR kodet (  ), të cilët gjenden në çdo faqe të testit.

Tek disa detyra do të zgjedhësh përgjigjen e saktë ashtu që do të ngjyrosësh rrethin e duhur. Te ato detyra tek të cilat ekzistojnë më tepër përgjigje të sakta është e nevojshme të ngjyrosen më shumë rrethë. Kujdesu që rrethi të jetë patjetër i ngjyrosur, sepse vetëm ashtu përgjigja do të pranohet si e saktë.

SHEMBULL I RRATHËVE TË NGJYROSUR
Tek detyra me një përgjigje të saktë
Cili është kryeqyteti i Republikës së Serbisë? Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë. <input type="radio"/> Novi Sadi <input checked="" type="radio"/> Beogradi <input type="radio"/> Nishi <input type="radio"/> Krushevci
Tek detyra me më shumë përgjigje të sakta
Ngjyros rrethët para shprehjes, shumën e të cilës është 5. <input checked="" type="radio"/> 2 + 3 <input type="radio"/> 1 + 2 <input checked="" type="radio"/> 4 + 1 <input type="radio"/> 2 + 4 <input type="radio"/> 3 + 5

- Nëse testin e përfundon para kohës së paraparë, atëherë dorëzo testin dhe largohu në qetësi.

Të dëshirojmë shumë suksese në provim!



## TESTI NGA MATEMATIKA

1. Ana gjatë ushtrimeve piu 0,2 litra ujë. Sa ujë Ana piu gjatë ushtrimeve?  
Ngjyrosni rrethin para përgjigjes së saktë.
- Piu gjysëm litre ujë.
  - Piu një të tretën e litrës së ujit.
  - Piu një të katërtën e litrës së ujit.
  - Piu një të pestën e litrës së ujit.
2. Pronari i një kompanie ka vendosur që një pjesë të fitimit mujor ta dhurojë për bamirësi. Në muajin maj kompania e tij fitoi 140 000 dinarë dhe për bamirësi ndau një të njëzetën e shumës. Sa ishte shuma që ai dhuroi për bamirësi?  
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- 70 dinarë
  - 700 dinarë
  - 7 000 dinarë
  - 70 000 dinarë
3. Çmimi i parkimit (në dinarë) llogaritet sipas kësaj formule

$$C = 120 + 90 \cdot (n - 1)$$

ku  $n$  është numri i orëve të parkimit.

Makina e Arbërit ka qenë e parkuar për 4 orë. Sa duhet të paguajë Arbëri për parkingun?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.


- 300 dinarë
- 390 dinarë
- 480 dinarë
- 630 dinarë






4. Në figurë janë dhënë katër gjysëmdrejtëza me pikë të përbashkët  $O$ , të cilat formojnë këndet. Ngjyrosni rrethin tek secili kënd duke treguar se çfarë këndi është.

	i ngushtë	i drejtë	i gjerë
këndi $\alpha$	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
këndi $\beta$	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
këndi $\gamma$	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>



5. Mjeshtri vizatoi një skicë të kontruksionit të kulmit i cili do të ndërtohet. Sa është gjatësia e trarit të shprehur me  $x$ ? Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- 5 m
- 12 m
- 16 m
- 17 m
- 20 m



6. Mimoza në punë shkon me autobus. Niset në ora 7 e 20 minuta dhe në punë arrin në orën 7 e 45 minuta. Nga puna kthehet në këmbë. Niset në ora 16 e 25 minuta dhe arrin në shtëpi në ora 17 e 25 minuta. Sa më shumë kohë iu është dashur për t'u kthyer në shtëpi, se sa për të shkuar në punë? Ngjyros rrethin përpara përgjigjes së saktë.

- 35 min
- 40 min
- 45 min
- 50 min
- 75 min


7. Sa mund të jetë lartësia nga dyshemeja deri në tavanin e dhomës së një shtëpie? Ngjyros rrethin përpara përgjigjes së saktë.

- 250 centimetra
- 250 milimetra
- 25 metra
- 100 centimetra
- 2 500 litra





8. Në grafikun e mëposhtëm janë paraqitur lumenjët më të gjatë në kontinente.



Ngjyros rrethin përpara përgjigjes të sakta.

- Lumi më i gjatë në botë gjendet në Afrikë.
- Nga lumenjët e treguar lumi me gjatësinë më të shkurtër është Volga.
- Jangcekajng është lumi më i gjatë në Amazon.
- Lumi më i gjatë në Australi ka gjatësinë më të vogël se 2 800 km.

9. Në bazë të të dhënave nga një faqe e internetit numri i popullatës në planetin Tokë shumë shpejtë do të arrijë numrin 8 000 000 000. Parashikohet se nëpër qytete do të jetojnë 60% e popullsisë. Në bazë të këtyre të dhënave sa do të jetë numri i banorëve, që do të jetojnë në qytete?


Ngjyros rrethin përpara përgjigjes së saktë.

- 6 000 000 000
- 4 800 000 000
- 3 200 000 000
- 6 000 000
- 4 800 000

10. Në një kompani secili i punësuar ka një numër identifikues të vetin. Numri përbëhet prej 7 shifrave, ku shifra e fundit është shifra e kontrollit. Shifra e kontrollit është mbetja nga mbledhja e 6 shifrave të para dhe pjesimi i tyre me 7. Cila shifër na mungon në figurë?

Ngjyros rrethin përpara përgjigjes së saktë.

- 0
- 1
- 2
- 3
- 4
- 5
- 6





11. Sa është vlera e shprehjes  $W = M - \frac{1}{M}$  nëse  $M = \left(\frac{1}{2} - \frac{1}{3}\right) \cdot (-6)$ ?

Ngjyros rrethin përpara përgjigjes së saktë.

- $W = -6$
- $W = -3$
- $W = -2$
- $W = -1$
- $W = 0$
- $W = 1$
- $W = 2$
- $W = 3$
- $W = 6$

12. Disa nga njësit për matjen e kapacitetit të memories janë: kilobajt (kB), megabajt (MB), gigabajt (GB) dhe terabajt (TB). Për kërkëto vlejn:

$$\begin{aligned}1 \text{ MB} &= 2^{10} \text{ kB} \\1 \text{ GB} &= 2^{10} \text{ MB} \\1 \text{ TB} &= 2^{10} \text{ GB}.\end{aligned}$$

Sa kilobajt ka një gigabajt?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- $2^{10} \text{ kB}$
- $2^{20} \text{ kB}$
- $4^{20} \text{ kB}$
- $2^{100} \text{ kB}$
- $4^{100} \text{ kB}$





13. Besimi do të përgadis 90 ëmbëlsira për festën familjare. Në recet ka përbërsit për 24 ëmbëlsira. Sa cokollad i duhet për 90 ëmbëlsira?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- 200 g cokollad
- 240 g cokollad
- 600 g cokollad
- 750 g cokollad
- 900 g cokollad



14. Blerta dëshiron të ndërtoj një shtresë mbrojtëse në form rrethi me qelq. Kompania e cila merret me preje me laser të qelqit i kerkon 200 dinarë për metër katror. Sa do i kushtojn Blertës 10 shtresa mbrojtëse me rreze 1 dm? (llogarisni je  $\pi \approx 3,14$ .)


Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- 200 dinarë
- 314 dinarë
- 400 dinarë
- 628 dinarë






15. Në figurë është paraqitur hapja e një prizmi trekëndor. Llogaritni sipërfaqen e prizmit?  
Trego ecurinë.



$S = \text{_____ cm}^2$

16. Sa boshte simetrie ka figura e dhënë?  
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- 1
- 2
- 3
- 4
- 5
- 6
- 8







17. Njehsoni.  
Tregoni ecurinë.

$$\left( \frac{3 - 1 \cdot 2}{2^2 \cdot \left(-\frac{1}{2}\right)^2} + \frac{2^4 - |-3 - (4 - 5)|}{-7} \right)^{2021}$$

Vlera është \_\_\_\_\_.

18. Arbani vendosi që në qershor pas përfundimit të vitit shkollor të punojë një muaj për të fituar ca dinarë. Kishte ofertë që të punojë një anketë për kërkime shkencore të një kompanie dhe ta promovojë në rrjetet sociale. Kompania do ta paguajë 5000 dinarë për punën e kryer dhe me nga 2 dinarë për secilën anketë të plotësuar. Nëse me  $x$  jepet numri i anketave, ndërsa me  $y$  të ardhurat në dinarë të Arbanit, cili barazim përshkruan lidhjen në mes dy madhësive?  
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- $y = 5\,000 + x$
- $y = 5\,000 \cdot (x + 2)$
- $y = 5\,000 + 2x$
- $y = 5\,000 - x$
- $y = 5\,000 - 2x$
- $y = 2 \cdot (x + 5\,000)$
- $2xy = 5\,000$
- $y = 5\,000 + x^2$






19. Në skicë është llogoja e kompanisë “Aurora”, e cila përbëhet nga dy gjashtëkëndësja të rregulltë. Faqja e gjashtëkëndëshit të madh është dy herë më e madhe se faqja e të voglit. Gjashtëkëndëshi i vogël duhet ngjyrosur me ngjyrën kafe, kurse pjesa e mbetur e gjashtëkëndëshit të madh me ngjyrë të verdhë. Nëse për ngjyrosjen e kësaj llojeje në ndërtesën e kompanisë janë shpenzuar 150 g ngjyrë kafe, sa gram ngjyrë të verdhë janë dashur për ngjyrosjen e pjesës tjetër?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- 150 g
- 200 g
- 300 g
- 450 g
- 600 g
- 900 g



20. Në ëmbëltoeren “Aurora” shiten ëmbëlsira me çmime si në tabelë.

**Çmimi i ëmbëlsirave në muajin maj**

Krem Torta .....	1 500 dinarë
Torta me Fruta .....	1 700 dinarë
Torta e ftohtë .....	1 800 dinarë

Për të tërhequr më shumë klientë, gjatë muajit korrik çmimet për Krem Tortë ranë për 20%. Sa % duhet të rritet çmimi i kësaj torte muajin e ardhshëm në mënyrë që çmimi të jetë si në muajin maj?

Tregoni ecurinë.

Çmimi duhet të rritet për \_\_\_\_\_%.



# FAQE E ZBRAZËT



**ИНТЕРФО**

EKZEMPLAR PËR SHKOLLËN

Republika e Serbisë  
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE E  
ZHVILLIMIT TEKNOLOGJIK  
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË  
ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

TË NGJITET TIKETA E IDENTIFIKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT FILLOR

# TESTI NGA MATEMATIKA

## FORMULARI I IDENTIFIKIMIT

EMRI, EMRI I NJËRIT PRIND/PËRFAQËSUESIT TJETËR LIGJOR, MBIEMRI I NXËNËSIT

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË NXËNËSIT

--	--	--	--	--	--	--	--

SHKOLLA FILLORE \_\_\_\_\_  
VENDI \_\_\_\_\_  
KOMUNA \_\_\_\_\_

NËNSHKRIMI I MËSIMDHËNËSIT KUJDESTAR

